



## Thirrje për shprehje të interesit

Prishtinë

17/07/2017

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” hap thirrjen për shprehje të interesit për një vlerësues (person fizik ose juridik) me qëllim të vlerësimit të projektit dy vjeçar “*Të mësuarit e bashkëpunimit ndërkufitar për menaxhimin e ekosistemeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm në rajonin e Maleve të Sharr*” (Janar 2015 – Korrik 2017)

*Projekti: “Të mësuarit e bashkëpunimit ndërkufitar për menaxhimin e ekosistemeve dhe zhvillimin e qëndrueshëm në rajonin e Maleve të Sharr”*

*Lokacioni: Kosovë*

### *Termet e referencës*

#### *Përmbledhje e projektit:*

Projekti “*Të mësuarit e bashkëpunimit ndërkufitar për menaxhimin e ekosistemeve dhe zhvillim të qëndrueshëm në rajonin e Maleve të Sharr*” është projekt dy vjeçar i bashkë-financuar nga Komisioni Evropian në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA), Komponenti II (Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar mes IRFJ e Maqedonisë-Kosovës). Projekti ka për qëllim krijimin e një rrjeti të komunikimit të drejtpërdrejt 'live' në mes të akademikëve dhe praktikuesve të mësimit bashkëpunues ndërkufitar për menaxhimin e ekosistemeve, me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë të burimeve natyrore dhe sigurimin e shërbimeve të ekosistemeve për një jetë të mirë në rajonin ndërkufitar të Maleve të Sharrit.

Ky projekt zbatohet nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", si koordinatar dhe partneri i saj “REC Kosova” në anën e Kosovës, si dhe Universiteti Shtetëror i Tetovës si koordinatar dhe partneri i saj Qendra për Zhvillim dhe Integrim Strugë (CDI) në anën e IRJ të Maqedonisë.





*Projekti synon të paraqes këto objektiva:*

1. Ngritjen e kapaciteteve në institucionet e arsimit të lartë të Kosovës dhe IRJ të Maqedonisë për menaxhimin e përbashkët të ekosistemeve ndërkufitare, si dhe forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet tyre dhe partnerëve tjerë (universiteteve dhe komunitetet për mbrojtje të natyrës) në Evropë.
2. Krijimin e një situatë prej të cilës do të fitojnë të dyja palët duke rritur bashkëpunimin ndërmjet universiteteve, autoriteteve që merren me konservimin e natyrës, palëve të interesit dhe OJQ-ve aktive në rajonin.
3. Rritjen e hulumtimeve të aplikuara në fushën e menaxhimit adaptiv të konservimit të ekosistemeve, zhvillimit të qëndrueshëm dhe adaptimin e ekosistemeve ndaj ndryshimeve klimatike, në mënyrë që të kontribuohet në gjetjen e zgjidhjeve për problemet aktuale.

### **Qëllimi i vlerësimit të projektit**

Qëllimi i kësaj konsulte është vlerësimi i rëndësisë, performancës, menaxhimit të aktiviteteve, ndikimin e aktiviteteve tek përfituesit përfshirë dhe kontributin e ngritjes së kapaciteteve, si dhe rekomandimet strategjike për vazhdimin e aktiviteteve në fazën tjetër.

Vlerësimi gjithashtu duhet të përfshijnë identifikimin/dokumentimin e mësimave të nxjerra dhe rekomandimeve që partnerët e projektit dhe palët e interesit mund të përdorin për të përmirësuar hartimin dhe zbatimin e projekteve dhe programeve të tjera të ngjashme, si dhe për të identifikuar hapa të mëtutjeshëm për tu zbatuar pas përfundimit të projektit.

*Përgjegjësitë kryesore:*

Vlerësuesi ka këto detyra parësore:

- Të vlerësojë rëndësinë dhe efektivitetin e strategjisë dhe qasjeve të projektit për arritjen e objektivave të projektit;
- Të vlerësojë performancën e projektit në aspektin e efektivitetit, efikasitetit dhe afateve kohore të prodhimit të rezultateve të pritura;
- Të vlerësojë cilësinë dhe afatin kohor të in puteve, sistemin e raportimit dhe monitorimit dhe shkallën në të cilën ato kanë qenë efektive;
- Të analizoje faktorët themelorë përtej kontrollit të UP-së që ndikojnë në arritjen e rezultateve të projektit;
- Të vlerësojë ndikimin e trajnimeve në ngritje e kapaciteteve të palëve të involvuara, me theks të veçantë stafit akademik dhe studentëve;
- Të vlerësojë rëndësinë e marrëveshjeve të menaxhimit të projektit; të identifikoj përparësitë, pengesat dhe mësimet që nxirren nga projekti;
- Të ofroj rekomandime për aktorët kryesorë të projektit për aktivitetet pasuese;





### *Produktet finale*

Rezultati e këtij vlerësimi do të përmbledhet në një **raport vlerësimi** në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze i cili nuk duhet të tejkalojë 30 faqe në total (duke përjashtuar anekset). Raporti duhet të:

- Përmban një përmbledhje ekzekutive (e detyrueshme)
- Jetë analitik (sasiorë dhe cilësorë)
- Jetë i strukturuar rreth çështjeve dhe gjetjeve të ngjashme / mësimëve të nxjerra
- Përfshije konkluzionet
- Përfshije rekomandime

### *Kualifikimet dhe përvoja profesionale e nevojshme:*

- Të ketë njohuri të mira për sistemin e arsimit të lartë në Kosovë,
- Të ketë njohuri dhe përvojë në vlerësimin e projekteve mjedisore, ndikimin në vlerësimin/zhvillimin e programit/strategjive.
- Të ketë përvojë të dëshmuar në vlerësimin e projekteve edukative,
- Shkathtësi të shkëlqyera të shkrimit,
- Kërkohet rrjedhshmëri në gjuhën shqipe dhe angleze.

### *Kriteret e përzgjedhjes:*

Kompania/kandidati do të vlerësohet në bazë të:

- Përgatitjes profesionale (20%) – diploma BSc. ose MSc. (lëmi, shkenca të natyrës, edukimit ose menaxhimit të projekteve)
- Eksperienca profesionale (60%) – aktivitete që lidhen me vlerësimin e menaxhimit të projekteve mjedisore dhe edukative.
- Çmimi për ditë pune (20%)

### *Kohëzgjatja e kontratës:*



This programme is funded by the EU



Kontrata parashihet që të zgjasë nga 1 Gushti deri 15 Shtator dhe përfshinë 10 ditë pune. Shërbimet duhet të zbatohen brenda periudhës së sipërpërmendur. Pagesat do të behet pas përfundimit të aktivitetit.

Personat/kompanitë e interesuar për këtë pozitë duhet të dërgojnë CV-in e tyre, kopje ne diplomës, dokumentet tjera që tregojnë përvojën e tij/saj dhe një letër mbështetës (jo më shumë se një faqe) në e-mail adresën: [behxhet.mustafa@uni-pr.edu](mailto:behxhet.mustafa@uni-pr.edu)

Afati i fundit për aplikim 24/07/2017 ora 16<sup>00</sup>

